



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

# Raport përmbledhës: Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi TM1 2024

Prishtinë, Maj 2024

## PËRMBLEDHJE E STATISTIKAVE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE DHE ÇMIMET NË BUJQËSI PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2024

---

Në këtë raport janë përmbledhur dhe analizuar statistikat për Indeksit e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi përgjatë periudhës 2020 – 2024. Agjencia e Statistikave të Kosovës bën grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në treg, ferma dhe vendet të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Prodhimet, që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale.

Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Ndërsa, në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë.

Peshat për kalkulimin e indekseve janë kryesisht të bazuara në Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi të vitit 2019-2021, që është vit bazë për indekset (2020=100).


## INDEKSI I TREMUJORIT TË PARË (TM1) 2020-2024 TË ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BIMORE DHE BLEGTORALE

Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurën e mëposhtme, evidentohen disa ndryshime në indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore për periudhat janar-mars të vitit 2023 dhe 2024. Në tremujorin e parë të vitit 2024, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje prej 2.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023.

Në të njëjtën periudhë, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka një rritje shumë më të lartë prej 7.3% krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo tregon një rritje më të shpejtë në çmimet e prodhimeve blegtorale, e cila mund të ketë arsye të ndryshme siç janë kërkesa e lartë për produkte blegtorale apo faktorë tjerë ekonomikë dhe mjedisore. Një rritje e tillë e çmimeve ka ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetet familjare dhe në çmimet e konsumit.

Indeksi total i çmimeve të prodhimeve bujqësore gjithashtu tregon një rritje prej 5.3% në tremujorin e parë të vitit 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Kjo rritje është ndikuar nga performanca e të dy sektorëve, bimor dhe blegtor, duke reflektuar një trend të përgjithshëm të rritjes së çmimeve në sektorin bujqësor.

Figure 1. *Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, blegtoriale dhe totali i prodhimeve bujqësore TM1 2020-2024, (2020=100)*




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në figurën 2, janë paraqitur ndryshimet e vlerës së misrit dhe grurit në periudhën janar-mars për vitet 2023 dhe 2024. Vlera mesatare e misrit për periudhën janar-mars ka shfaqur ndryshime të rëndësishme ndër vite. Në vitin 2023, mesatarisht ishte 0,38, ndërsa për vitin 2024, ka rënë në rreth 0,33. Kjo tregon një rënie në vlerën e misrit në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Ndërsa, sa i përket grurit, vërehet një zbritje e ndjeshme në çmimin mesatar të grurit për periudhat janar-mars të vitit 2023 dhe 2024.

Në vitin 2023, mesatarja e çmimit ishte rreth 0.30, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2024, mesatarja ra në 0.20. Kjo tregon një zbritje të rëndësishme në çmimin e grurit mes këtyre dy periudhave.

*Figure 2 Çmimi mesatar absolut për grurë dhe misër, Janar- Dhjetor 2023 - 2024.*



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Në Figurën 3, prezantohet një përmbledhje e të dhënave statistikore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila tregon një rritje në çmimin mesatar absolut për mëzet dhe mëshqerra për periudhën janar-mars në vitet 2023 dhe 2024. Gjatë kësaj periudhe, çmimi mesatar ishte rreth 3,58 për vitin 2023, ndërsa për vitin 2024, kemi vërejtur një rritje në çmim, me një mesatare prej rreth 3,68 për peshë të gjallë . Ndërkaq, për të njëjtën periudhë janar-mars të vitit 2023, çmimi mesatar absolut për derrat ka qenë rreth 3,5, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2024, kemi parë një rritje në çmim, duke shkuar në rreth 3,70.

Figurën e mëposhtme, evidentohet një rritje e ndjeshme në çmimin mesatar absolut për delet për periudhën janar-mars, duke shkuar nga rreth 3,45 në vitin 2023 në rreth 3,88 në vitin 2024.

Kjo rritje e ndjeshme në çmim tregon për një zhvillim të rëndësishëm në treg në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023. Disa faktorë që mund të kenë ndikuar në këtë rritje përfshijnë

kërkesën e lartë për llojet e mishit, ndryshimet në kostot e prodhimit, politikat e tregut dhe kushtet e mjedisit.

Figure 3 Çmimi mesatar absolut për mëzet dhe mëshqerra, derra dhe dele si peshë e gjallë.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

## INDEKSI TREMUJOR I ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BUJQËSORE TM1 2020-2024 (2020=100)

Tabela 1 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM1 2020-2024 (2020=100)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	TM1 2020	TM1 2021	TM1 2022	TM1 2023	TM1 2024
<b>010000</b>	<b>DRITHËRAT (përfshirë farërat )</b>	<b>109,2</b>	<b>94,4</b>	<b>145,7</b>	<b>156,4</b>	<b>114,3</b>
011000	Grurë dhe spelt (spelt = Triticum aestivum spelta)	113,4	92,8	150,9	157,7	107,0
011100	Grurë i butë dhe speltë	113,4	92,8	150,9	157,7	107,0
012000	Thekërë dhe meslin (meslin = përzierje gruri dhe thekërë, lloj drithi)	102,3	95,7	110,9	124,8	111,9
013000	Elb	104,9	85,4	102,6	130,5	98,6
013200	Elb për prodhimin e birrës	104,9	85,4	102,6	130,5	98,6
014000	Tërshër dhe perzierje të drithërave verore	90,5	104,9	113,2	140,1	104,5
015000	Misër kokërr	102,0	97,5	138,4	155,4	129,1
<b>030000</b>	<b>BIMË FORAGJERE</b>	<b>99,5</b>	<b>109,6</b>	<b>136,1</b>	<b>147,1</b>	<b>116,1</b>
031000	Misër për ushqim kafshësh	99,1	102,2	141,9	166,1	110,1
032000	Kultura tuberoze për ushqim kafshësh (përfshirë panxharin foragjerë)	:	:	:	:	:
039000	Bimë tjera foragjere	99,6	110,4	135,4	145,1	116,7
<b>040000</b>	<b>PERIME DHE PRODUKTE TJERA HORTIKULTURORE</b>	<b>109,2</b>	<b>109,1</b>	<b>117,5</b>	<b>128,4</b>	<b>160,2</b>
041000	Perime të freskëta	109,2	109,1	117,5	128,4	160,2
041100	Lulelakër	:	:	:	:	:
041200	Domate	:	:	:	:	:
041900	Perime tjera të freskëta	109,2	109,1	117,5	128,4	160,2
042000	Bimë dhe lule	:	:	:	:	:
<b>050000</b>	<b>PATATE (përfshirë farërat)</b>	<b>93,6</b>	<b>111,6</b>	<b>165,3</b>	<b>166,9</b>	<b>212,1</b>
051000	Patate për konsum	93,6	111,6	165,3	166,9	212,1
<b>060000</b>	<b>PEMË</b>	<b>96,9</b>	<b>96,1</b>	<b>88,6</b>	<b>104,2</b>	<b>138,7</b>
061000	Pemë të freskëta pa i përfshirë agrumet dhe mushin	96,9	96,1	88,6	104,2	138,7
061100	Mollë tryeze	90,5	91,5	81,7	102,8	138,0
061200	Dardhë tryeze	118,7	110,4	104,5	111,6	133,0
061300	Pjeshkë	:	:	:	:	:
061900	Pemë të freskëta arrë,lajthi,gështenjë dhe fruta të tharë	107,1	104,3	103,3	105,1	143,7
062000	Agrume	:	:	:	:	:
063000	Pemë tropikale	:	:	:	:	:
064000	Rrush	:	:	:	:	:
<b>100000</b>	<b>PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>102,6</b>	<b>103,3</b>	<b>132,3</b>	<b>142,2</b>	<b>146,3</b>
<b>101000</b>	<b>PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), pa i përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>102,1</b>	<b>103,4</b>	<b>149,1</b>	<b>157,2</b>	<b>144,0</b>
<b>110000</b>	<b>BLEGTORIA</b>	<b>100,4</b>	<b>101,4</b>	<b>129,2</b>	<b>144,6</b>	<b>159,1</b>
111000	Gjedhët	99,3	101,5	118,3	140,2	153,9
111100	Gjedhët pa i përfshirë viçat	100,8	99,7	116,6	148,2	154,1
111200	Viçat	96,4	105,1	121,7	124,8	153,6
112000	Derrat	98,4	101,3	141,4	159,6	167,5
113000	Njëthundrakët ( Kuaj,Gomarë,Mushka)	:	:	:	:	:
114000	Dele dhe dhi	105,1	101,5	141,8	149,1	170,5
115000	Shpezët	94,7	101,4	113,4	122,0	131,7
115100	Pulat	94,7	101,4	113,4	122,0	131,7
115900	Shpezët tjera	94,7	101,4	113,4	122,0	131,7
119000	Kafshë tjera	:	:	:	:	:
<b>120000</b>	<b>PRODHIMET BLEGTORIALE</b>	<b>100,0</b>	<b>94,6</b>	<b>105,2</b>	<b>124,7</b>	<b>131,2</b>
121000	Qumësht	100,0	94,6	105,2	124,7	131,1
121100	Qumësht lope	100,0	94,6	105,2	124,7	131,1
121900	Lloje tjera qumshli	:	:	:	:	:
122000	Veçë	106,6	106,7	123,3	147,8	130,2
129000	Produkte tjera blegtorale	98,8	105,8	107,0	122,7	133,9
<b>130000</b>	<b>BLEGTORIA DHE PRODHIMET BLEGTORIALE (110000+120000)</b>	<b>100,2</b>	<b>97,4</b>	<b>115,2</b>	<b>132,9</b>	<b>142,7</b>
<b>140000</b>	<b>GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>101,2</b>	<b>100,0</b>	<b>122,6</b>	<b>137,0</b>	<b>144,3</b>
<b>141000</b>	<b>GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), pa përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>100,8</b>	<b>99,4</b>	<b>126,2</b>	<b>140,8</b>	<b>143,1</b>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

## INDEKSI MUJOR I ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BUJQËSORE NË BAZË TË GRUPEVE

Tabela 2 Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, janar-mars 2024 (2020=100)

Kodi i artikullit	Grupet	Peshat		2024		
		%	1000 Euro	Jan	Shk	Mar
<b>0 1</b>	<b>Drithërat</b>	<b>104</b>	<b>37.259</b>	<b>113,1</b>	<b>113,9</b>	<b>115,0</b>
0 1.1	Grurë	69	24.761	106,6	106,6	108,3
0 1.3	Elb	1	362	96,3	99,0	100,6
0 1.5	Misër	33	11.781	127,7	130,0	130,0
0 1.9	Drithëra tjera	1	354	107,6	105,4	105,4
<b>0 3</b>	<b>Bimët foragjere</b>	<b>64</b>	<b>22.984</b>	<b>114,3</b>	<b>118,5</b>	<b>116,6</b>
0 3.1	Misër për ushq. kafshëve	9	3.351	112,9	113,6	100,7
0 3.9	Bimët tjera foragjere	55	19.633	114,6	119,3	119,3
0 3.9.1	Sanë	36	12.949	114,7	119,0	119,0
0 3.9.2	Kashtë	3	1.234	132,5	138,8	138,8
0 3.9.9	Bimët tjera foragjere :tjera	15	5.450	110,2	115,6	115,6
<b>0 4</b>	<b>Perimet</b>	<b>230</b>	<b>82.709</b>	<b>159,3</b>	<b>162,0</b>	<b>158,9</b>
0 4.1	Perimet e freskëta	230	82.709	159,3	162,0	158,9
0 4.1.2	Domate	24	8.464	:	:	:
0 4.1.9	Perimet tjera të freskëta	206	74.246	159,3	162,0	158,9
0 4.1.9	Speca	84	30.370	:	:	:
0 4.1.9.1	Lakër	16	5.800	147,5	167,6	:
0 4.1.9.4	Tranguj	9	3.379	:	:	:
0 4.1.9.6	Qepë	16	5.883	189,9	195,9	198,9
0 4.1.9.7	Fasulja	25	8.865	152,4	152,4	160,4
0 4.1.9	Shalqi	14	5.084	:	:	:
0 4.1.9.9.9	Perimet tjera të freskëta: tjera	41	14.863	160,1	153,2	119,3
<b>0 5</b>	<b>Patatet</b>	<b>71</b>	<b>25.637</b>	<b>200,7</b>	<b>220,3</b>	<b>220,3</b>
<b>0 6</b>	<b>Pemët</b>	<b>151</b>	<b>54.336</b>	<b>132,4</b>	<b>140,8</b>	<b>147,2</b>
0 6.1	Pemët e freskëta	111	39.796	132,4	140,8	147,2
0 6.1.1	Molla	31	11.254	128,4	140,1	147,1
0 6.1.2	Dardha	11	4.070	133,0	:	:
0 6.1.9	Pemët tjera	68	24.472	142,8	142,9	147,3
0 6.1.9.2	Kumbulla	12	4.178	:	:	:
0 6.1.9.4	Frutat e thata,Gështenjë	8	2.801	144,3	144,2	147,3
0 6.1.9.9	Pemët tjera,të tjera	49	17.492	139,5	140,6	:
0 6.4.1	Rrush	9	3.415	:	:	:
0 6.4.9	Rrush për verëra	31	11.125	:	:	:
<b>10</b>	<b>Prodhimet bimore</b>	<b>620</b>	<b>222.925</b>	<b>145,2</b>	<b>151,0</b>	<b>151,4</b>
<b>11</b>	<b>Blegtoria</b>	<b>157</b>	<b>56.490</b>	<b>158,1</b>	<b>159,6</b>	<b>159,7</b>
11.1	Mëzet dhe Mëshqerra	63	22.767	154,0	153,6	154,1
11.2	Derra	29	10.463	161,4	170,6	170,6
11.4	Dele	48	17.221	170,5	170,5	170,5
11.5	Pula	17	6.039	132,1	132,0	131,0
11.9	Kafshë - tjera	0	-	:	:	:
<b>12</b>	<b>Prodhimet blegtorale</b>	<b>223</b>	<b>80.146</b>	<b>131,2</b>	<b>131,1</b>	<b>131,1</b>
12.1	Qumësht	223	80.109	131,1	131,1	131,1
12.2	Veze	0	23	140,7	128,4	121,6
12.9	Prodhimet tjera blegtorale	0	14	133,9	133,9	133,9
<b>13</b>	<b>Blegtoria dhe prodhimet blegtorale</b>	<b>380</b>	<b>136.636</b>	<b>142,3</b>	<b>142,9</b>	<b>143,0</b>
<b>14</b>	<b>Totali i prodhimeve bujqësore</b>	<b>1000</b>	<b>359.561</b>	<b>144,1</b>	<b>147,9</b>	<b>148,2</b>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

## ÇMIMET MESATARE MUJORE PËR DISA PRODHIME BUJQËSORE

Tabela 3, Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore janar-mars 2024

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Kodi i artikullit	Prodhimet	Njësia	2024		
			Jan	Shk	Mar
01.1.	Gruri <sup>1</sup>	kg	0,21	0,21	0,21
01.3.	Elbi <sup>2</sup>	kg	0,30	0,30	0,31
01.5.	Misri <sup>3</sup>	kg	0,32	0,32	0,32
01.2.	Thekër <sup>4</sup>	kg	0,37	0,37	0,37
01.4.	Tërshërë <sup>5</sup>	kg	0,32	0,31	0,31
03.9.1	Sana <sup>6</sup>	kg	0,18	0,18	0,18
03.9.2	Kashta <sup>7</sup>	kg	0,11	0,11	0,11
03.9.9.	Jongja <sup>8</sup>	kg	0,20	0,21	0,21
05.1.	Patate <sup>9</sup>	kg	0,73	0,80	0,80
04.1.9.1	Lakëra <sup>10</sup>	kg	0,36	0,41	:
04.1.9.6	Qepa <sup>11</sup>	kg	0,90	0,93	0,94
04.1.9.9.9	Speca <sup>12</sup>	kg	:	:	:
04.1.9.3	Spinaqi <sup>13</sup>	kg	2,14	1,60	1,10
04.1.9.7	Fasulja <sup>14</sup>	kg	4,07	4,07	4,29
04.1.2	Domatja <sup>15</sup>	kg	:	:	:
04.1.9.4	Tranguj <sup>16</sup>	kg	:	:	:
04.1.9.9.9.1	Shalqi <sup>17</sup>	kg	:	:	:
04.1.9.9.9.2	Presh <sup>18</sup>	kg	1,26	1,23	1,19
04.1.9.9.9.3	Hudher <sup>19</sup>	kg	4,14	4,21	4,43
06.1.1	Molla <sup>20</sup>	kg	0,79	0,86	0,90
06.1.2	Dardha <sup>21</sup>	kg	1,60	:	:
06.1.3	Gëshlënja <sup>22</sup>	kg	3,64	:	:
06.1.9	Arra <sup>23</sup>	kg	3,29	3,29	3,36
06.1.4.1	Rrush <sup>24</sup>	kg	:	:	:
11,1	Mëzet dhe meshqerra <sup>25</sup>	kg	3,67	3,66	3,67
11,2	Derra <sup>26</sup>	kg	3,54	3,74	3,74
11,4	Dele <sup>27</sup>	kg	3,92	3,92	3,92
11,5	Pula ( Fshali) <sup>28</sup>	1 copë	14,57	14,57	14,43
11.5.1	Pula ( ferme) <sup>29</sup>	1 copë	3,13	3,12	3,13
12,1	Qumësht <sup>30</sup>	1 lit	0,44	0,44	0,44
12,9	Mjalt <sup>31</sup>	kg	15,43	15,43	15,43
12,2	Veze <sup>32</sup>	30 copë	3,45	3,15	2,98





ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: [info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org)

Web: [www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org)